



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 104/2013
Prishtinë, më 07.05.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N–303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Visar Ymeri dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës i ftuar: Haliti Gara, kryesues i Bordit i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave.

Pjesëmarrës të tjerë: Ilmi Ahmeti, Gëzim Qërimi dhe Enis Berisha- ARH; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi– INDEP; dhe Qëndresa Mrasori- praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.04.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave –ARH për vitin 2012;
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.04.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 30.04.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullator të Hekurudhave –ARH për vitin 2012

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2012. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit Rregullator të Hekurudhave-ARH-së, z. Haliti Gara, i cili do të paraqesë një prezantim të shkurtër për këtë Raport në Komision. Pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Halit Gara kryesues i Bordit i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave - I njoftoi deputetët për aktivitetet që ka bërë ARH-ja për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Ligji për Hekurudhat e Kosovës. Ai tha se vitin i kaluar i kemi vazhduar aktivitetet që kanë qenë shumë dinamike për ARH-n. Theksoi se në bazë të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës kemi filluar ristrukturimin e departamenteve, ndryshimin e rregulloreve dhe hartimin e udhëzimeve administrative, për çështjet që kanë të bëjnë lidhur me licencat. Ai në vijim njoftoi për formimin e departamentit për mbikëqyrjen e sigurisë, njoftoi se janë përcaktuar procedurat dhe kriteret e lëshimit të licencave për operime, për mbikëqyrjen e binareve të hekurudhave. Për departamentin për hetim të aksidenteve, ai tha që në bazë të ligjit të ri që është aprovuar janë bartur kompetencat në Zyrën e Kryeministrit, po ashtu, ai njoftoi për bashkëpunimin me institucionet e tjera relevante që ka pasur ARH-ja. Z. Haliti Gara, në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që ka marrë ARH-ja, duke filluar nga puna e deritashme dhe sfidat që e përcjellin ARH-në. Z. Gara theksoi se në funksion të zbatimit të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, në fokus të angazhimeve do të mbeten në tërësi realizimi i objektivave që janë paraparë për vitin 2013.

Kryetari – Tha se ky raport është i një kualiteti më të mirë se sa raporti i viti të kaluar, por mbetet ende për t’u përmirësuar, në raport duhet më pas kohezion prej viti në vit. Kërkoj që raporti i viti të kaluar të bëhet publik në WEB- faqe të ARH-së, për të pasur mundësi që të bëhen krahasimet. Ai pyeti për fillimin e licencave që kanë filluar të lëshohen për infrastrukturën që kanë se sa janë realizuar?

Teuta Sahatqija - Lidhur me raportin, ajo tha, që vit pas viti për nga ana teknike e hartimit po përmirësohet, por duhet që në përmbajtje të janë edhe detajet se si janë zhvilluar aktivitetet e ARH-së. Pyeti për kodin e përkohshëm që e përdorin hekurudhat e Kosovës, se si është i rregulluar, cilat janë kompetencat dhe çka varet prej ARH-së? A ka kërkesa nga kompanitë siç janë Trepça dhe Ferronikeli që transportin hekurudhor ta bëjnë me mjetet e tyre vetanake?

Myzejene Selmani – Kërkoj nga përfaqësuesi i ARH-së që të sjellin në Komision edhe një raport shtesë më analiza krahasuese prej viti në vit. Tha që në bazë të ligjit janë formuar disa departamente dhe puna e tyre në raporte është në formë telegrafike, shumë e shkurtë. Pastaj parashtrroi disa pyetje për operatorët që kanë marrë licenca së çka është arritur prej këtyre licencave? Cilat janë të dhënat për infrastrukturën e hekurudhave? Cilat janë të hyrat vetanake

nga licencat e ARH-së? Cilat janë pengesat që po ju paraqitën në Ligjin për hekurudhat e Kosovës?

Lutfi Zharku – Pyeti për çështjen e regjistrimit të infrastrukturës së hekurudhave se sa janë regjistruar? Për tarifat e infrastrukturës së hekurudhave të propozuara nga “INFRAKOS-i”, se cili do të jetë vendimi përfundimtar i ARH-së? Dhe a konsideron se çmimet e tarifave janë shumë të larta?

Hashim Deshishku – Parashtroi disa pyetje, për tarifat e infrastrukturës së hekurudhave të propozuar pse ARH-ja nuk ka vendosur vetë, dhe pse është dashur që të marrë vendim përfundimtar Ministra e Infrastrukturës që t’i aprovojë tarifat? Për shpenzimet kapitale për veturën që është blerë, a i është dashur për nevojat dhe punën e ARH-së kjo veturë? Për shpenzimet për shërbime për cilat shërbime bëhet fjalë? Për hekurudhat në veri të Kosovës keni bërë kërkesë për të shkuar për ta regjistruar gjendjen e tyre? A po shkon në rritje numri i transportit të udhëtarëve dhe mallrave?

Haliti Gara kryesues i Bordit i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave - tha se pajtohet që raporti nuk është shumë i detajuar, por që kanë pasur sugjerime nga ekspertë të Komisionit Evropian që të mos ngarkohet shumë me detaje, se e kemi larguar pjesën teorike të aktiviteteve nga raporti.

Enis Berisha drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave - Ju përgjigj pyetjeve që ngritën anëtarët e Komisionit. Sa i përket kodit, tha që janë bazuar në Ligjin e Hekurudhave dhe në direktivat e BE-së. Për mjete lëvizëse të trenave dhe të infrastrukturës kemi regjistrim të saktë të mjeteve lëvizëse dhe të infrastrukturës. Për çështjen e sigurisë, departamenti i sigurisë e ka filluar përgatitjen rregulloreve dhe formularëve për aplikim, pastaj edhe ARH-ja ka bërë lëshimin e certifikatave të sigurisë. Për të hyrat vetanake Ministria e Infrastrukturës, sipas udhëzimit administrativ ka përcaktuar që këto licenca janë pa pagës. Për çmimet e tarifave, edhe ARH-ja ka dhënë vërejtje e tyre se çmimet janë shumë të larta, por këto tarifa në bazë të Ligjit i ka miratuar MI-ja. Për shpenzimet e shërbimeve, është term që përdoret nga thesari. Për blerjen e veturës ka qenë një kërkesë dhe ka pasur nevojë që ARH-ja ta disponojë një veturë për nevojat e veta.

Lutfi Zharku- Kërkoj që ARH-ja të jetë më shumë e përfshirë për çmimet e tarifave që të jenë më të ulëta, që transporti i hekurudhave të jetë më i lirë se sa transporti i rrugor.

Enis Berisha drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave - Tha se kemi bërë krahasime me vendet e rajonit se cilat janë çmimet e tyre, por kompania i “INFRAKOS-it,” i ka propozuar çmimet e tarifave dhe MI-ja i ka kompetencat për të vendosur.

Halit Gara kryesues i Bordit i Autoritetit Rregullator të Hekurudhave – Në fund tha se do t’ju ofrojmë të gjitha të dhënat që nuk janë përfshirë në këtë raport që u propozuan dhe do t’ju sjellim edhe një raport shtesë më të dhëna ma të hollësishme për gjitha çështjet që u kërkuar.

Kryetari - Në fund të diskutimeve që bënë dhe përgjigjeve që morën deputetët lidhur me interesimin e tyre, raportin e ARH-së për vitin 2012 e vlerësoi pozitivisht. Ai, po ashtu, në emër të Komisionit e inkurajoi kryesuesin, z. Gara dhe stafin e ARH-së që të vazhdojnë me këmbëngulësi për të ju përmbajtur rekomandimeve të dala nga Komisioni Evropian, për përmbushjen e direktivave të BE-së, Raportit të Progresit dhe Raportit të Auditorit Gjeneral. Theksoi se për t’i tejkaluar sfidat që mund të paraqiten gjatë zbatimit të Ligjit për Hekurudhat do t’ju ofrojmë mbështetjen e vazhdueshme të Komisionit.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2012.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i punës së Autoritetit Rregullator të Hekurudhave për vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Raporti Vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE-së për vitin 2012.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit